

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tiparet - A jemi të gjithë paksa narcistë?
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916135/a-jemi-te-gjithe-paksa-narciste/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 10:14:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 10:10:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4b03685ccce277beffd130eead9d4063361d21fa18892996df651b0a4f7ca821
TEKSTI	812d6e820c8e651b288404086bcb7f7fbbfccd3ee81da72293946b51c9177012
PAMJA	ce0cce268361e9c5e5f7ef6ef01e24d915d47aa2f7afd4943678b7e7743c74ad

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	367a36a41367afc4e706ac9454f7bf9f5765dcef16af49622a6522619d467345
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d64b19d4495c04a1879b548eb4acc42b7d675e081280586bffd66b65486cb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/367a36a41367afc4e706ac9454f7bf9f5765dcef16af49622a6522619d467345>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AGIM XHAFKA
Dialog me mbesënNDRIM KULLA
Shoqëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut

më të lexuarat

SYRI TV/ Elbasan, 92 familje pa ujë të pijshëm, banorët në Fushë Bual, kërkojnë zgjidhje

SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra, Bankers tërhiqet, banorët arrijnë marrëveshje me firmën

Brenda kolapsit të agjencisë së surrogacisë që u kushtoi grave surrogate dhe prindërve të ardhshëm ëndrrat e paratë e tyre

Sot priten reshje shiu në të gjithë territorin, njihuni me parashikimin e motit dhe sa do të jenë temperaturat

Parashikimi i horoskopit 12 shtator, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot

Banorët ngujohen në zyrat e Bankers: Presim zgjidhje për qiratë e tokave



A jemi të gjithë paksa narcistë?

12:10, 12/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Kaytee Gillis – Psychology Today

Shumica prej nesh, në një moment të jetës, kemi bërë diçka që mund të duket egoiste. Ndoshta e kemi kthyer një bisedë të vetja kur dikush tjetër kishte nevojë për mbështetje. Ndoshta e kemi pasur të vështirë të kuptonim ndjenjat e dikujt, sepse ishim të zhytur në lëndimin tonë. Mund të jemi bërë mbrojtës kur dikush na ka vënë përballë një gabimi që kemi bërë. Madje, ndonjëherë mund të jemi përpjekur pak më shumë seç duhet për të shpjeguar pse diçka nuk ishte vërtet faji ynë.

A do të thotë kjo se jemi narcistë? Me shumë gjasa, jo.

Një nga problemet me mënyrën se si flasim sot për narcizmin është se ky term është kthyer në një etiketë që përdoret për pothuajse çdo sjellje që nuk na pëlqen. Një ish-partner që ka tradhtuar është narcist. Dikush që flet shumë për veten është narcist. Një prind i vështirë është narcist. Dikush që refuzon të kërkojë falje? Patjetër që është narcist.

Nëse kaloni mjaftueshëm kohë në rrjetet sociale, mund t'ju duket sikur të gjithë kanë çrregullim të personalitetit narcist. Por tiparet narciste dhe çrregullimi i personalitetit narcist nuk janë e njëjta gjë.

Tiparet narciste ekzistojnë në një spektër

Shumica prej nesh mund të shfaqim, dhe me siguri do të shfaqim, mungesë empatie apo edhe disa tipare narciste në një ose më shumë momente të jetës. Njerëzit janë të papërsosur. Ndonjëherë mund të jemi egoistë, mbrojtës, të pandjeshëm, xhelozë, të kërkojmë vëmendje ose të kemi mungesë empatie, pa përmbytur kriteret për një çrregullim personaliteti. Dallimi mes një tipari që shfaqet rrallë dhe narcizmit të mirëfilltë qëndron te mungesa e vazhdueshme e empatisë ose e aftësisë për të kuptuar se si veprimet tona ndikojnë te të tjerët. Shumica e njerëzve, pasi tensioni i një debati të ketë kaluar, mund të mendojnë për mënyrën se si mund ta kenë lënduar tjetrin. Por njerëzit pa empati nuk janë në gjendje të reflektojnë dhe të ndiejnë pendesë.

"Mos vallë jam narcist?" mund të pyesni veten. Nëse ia bëni vetes këtë pyetje për marrëdhënien tuaj me të tjerët, ka shumë gjasa që po tregoni një vetëreflektim normal. Kjo nuk do të thotë se jeni të imunizuar ndaj sjelljeve narciste herë pas here. Të gjithë mund të sillemi në këtë mënyrë në një moment të jetës. Dallimi është se, nëse jemi në gjendje ta kuptojmë këtë, ta pranojmë përgjegjësinë dhe të

përpiqemi me vetëdije të sillemi më mirë, kemi më pak gjasa t'u shkaktojmë të tjerëve dëme të mëtejshme.

Si psikoterapistë, përpiqem të kuptoj "pse-në" e disa sjelljeve dhe qëllimin që fshihet pas tyre në një marrëdhënie. I nxis njerëzit të vëzhgojnë modelet e sjelljes. Kur kuptoni se keni lënduar dikë, çfarë ndodh më pas? A jeni në gjendje ta pranoni pa filluar menjëherë të shpjegoni pse në të vërtetë faji ishte i personit tjetër? A mund ta përballoni të dëgjoni se si sjellja juaj ka ndikuar te një person tjetër? A mund të kërkonti falje? Dhe, ndoshta më e rëndësishmja, a mund ta ndryshoni sjelljen tuaj?

Përdorimi i lirshëm i etiketave mund të shkaktojë dëm

Përdorimi i termave mjekësorë, sado të zakonshëm të jenë bërë në gjuhën e përditshme, mund të çojë në patologjizimin e njerëzve. Ashtu siç jo çdo mendim i ndryshëm nuk është "gaslighting", edhe jo çdo person që ka mungesë empatie mund të cilësohet si dikush me një çrregullim të plotë personaliteti. Madje, as të gjithë njerëzit me çrregullim të personalitetit narcist nuk janë mizorë apo keqdashës.

Në ditët e sotme, duket sikur kushdo që ka marrë një "diplomë nderi" në psikologji nga Universiteti i Google e ndien veten të kualifikuar për t'i diagnostikuar të tjerët si narcistë. Megjithatë, në realitet, shumë pak prej këtyre pretendimeve të rastësishme për çrregullimin e personalitetit narcist janë të sakta. Të jesh narcist është diçka më shumë sesa thjesht të jesh i përqendruar te vetja.

Ashtu si me të gjitha diagnozat e shëndetit mendor, paqartësia rreth këtij termi ka bërë që platformat e rrjeteve sociale si Facebook, Instagram dhe TikTok të kthehen në hapësira ku diagnozat e dhëna nga njerëz të pakualifikuar mund të bëhen virale. Si terapistë, më vjen mirë që shoqëria po diskuton më shumë për shëndetin mendor dhe se shumë prej pacientëve të mi kanë gjetur terma dhe shpjegime që i ndihmojnë të kuptojnë përvojat e tyre. Në të njëjtën kohë, përdorimi i tepërt dhe banalizimi i këtyre termave mund t'ua zbehtë vlerën.

Shumica prej nesh do të sillemi në mënyrë egoiste herë pas here. Shumica do të bëhemi mbrojtës. Do të kemi momente kur empatia do të jetë e vështirë, sepse jemi të pushtuar nga emocionet tona. Dhe shumica prej nesh, në një moment, do të lëndojmë dikë që e kemi për zemër, edhe kur nuk e kemi pasur kurrë qëllim ta bëjmë këtë.

Ajo që ka rëndësi është se çfarë ndodh kur përballemi me pasojat që sjell sjellja jonë. A dimë të dëgjojmë? A jemi në gjendje të reflektojmë? A mund të marrim përgjegjësi? Dhe a mund ta ndryshojmë vërtet mënyrën se si do të sillemi herën tjetër? Nëse po, atëherë kjo ka shumë gjasa të jetë thjesht pjesë e të qenit njerëzor. Nëse jo, atëherë ndoshta kemi të bëjmë me një problem më të thellë.

/Psychology Today – Syri.net

© SYRI.net

Lexo edhe:



Përshkallëzohet protesta në Vlorë/ Përplasje me policinë te kantieri i muzeut hebraik



Banorët e Rrjollit rikthehen në protestë: Toka është e jona, nuk do lëshohet



Shenjat më me fat të zodiakut këtë sezon të Virgjërshës

Parashikimi i horoskopit 10 shtator, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot

Moti parashikohet me kthjellime dhe vranësira, si do të jenë temperaturat

PISA 2025/ Si u deformuan të dhënat nga qeveria, reagon OECD: Nuk i miratuam ndryshimet

TË NGJASHME



Pse i hanë fëmijët sekrecionet e hundës?



PISA 2025/ Si u deformuan të dhënat nga qeveria, reagon OECD: Nuk i miratuam ndryshimet



Parashikimi i horoskopit 12 shtator, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot



Sot priten reshje shiu në të gjithë territorin, njihuni me parashikimin e motit dhe sa do të jenë temperaturat



VIDEO/ Elbasan, tension në Këshillin
Bashkiak, opozita: Fondi i
emergjencave nuk po përdoret nga
mungesa e planifikimit

Brenda kolapsit të agjencisë së
surrogacisë që u kushtoi grave
surrogate dhe prindërve të ardhshëm
ëndrrat e paratë e tyre

SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra,
Bankers tërhiqet, banorët arrijnë
marrëveshje me firmën

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.